



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 dhjetor 2019
Nr. ref.: RK 1476/19

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI102/19

Parashtrues

Bedri Gashi

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit për
Papranueshmëri Nr. KI174/18, të 7 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta-Rama Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bedri Gashi, avokat nga komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon “rishqyrtim” të Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI174/18, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 7 majit 2019 në lidhje me “tri shkresa” të Zyrës së Prokurorit Disiplinor (në tekstin e mëtejme: ZPD) përkitazi me hetimet disiplinore që ai inicioi kundër gjyqtarit H. G. për shkak të sjelljes “joprofesionale” të gjyqtarit H. G.
3. Shkresat e kontestuar të ZPD-së janë:
 - (i) ZPD/14/zp/437, e 28 prillit 2014;
 - (ii) ZPD/18/kb/223, e 5 qershorit 2018; dhe
 - (iii) ZPD/17/zp/425, e 9 gushtit 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI174/18, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 7 majit 2019 në lidhje me tri shkresat e ZPD-së, të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkak të sjelljes “joprofesionale” të gjyqtarit H. G., kanë shkelur qëllimisht të drejtat kushtetuese të klientëve të tij, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përmes shërbimit postar e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 21 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.
8. Më 2 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua ZPD-së.
9. Më 7 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën nr. KI174/18. Në atë kërkesë, parashtruesi kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë e tri shkresave të ZPD-së lidhur me sjelljen “joprofesionale” të gjyqtarit H. G.
11. Më 10 prill 2019, Gjykata shpalli kërkesën nr. KI174/18 të papranueshme.
12. Më 27 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI102/19, me ç’ rast kërkoj “rishqyrtim” të Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI174/18, në lidhje me tri shkresat e ZPD-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës, sikurse në kërkesën nr. KI174/18, pretendon: *“Nuk mundemi të hyjmë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, por duam të paktën kjo gjykatë t’i konstatojë, përkatësisht t’i evidentojë veprimet e gjyqtarit H. G. dhe 3 prokurorëve tjerë të ZPD-së, të konstatojë si shkelje ligjore të tyre-përfshi edhe N. H. e heshtur dhe gjykata të bie aktvendim: (1) aprovohet kërkesa e palëve të paraqitura, për rishqyrtimin e kërkesës, lidhur me shkeljet e të drejtave ligjore; (2) gjykata të konstatojë, se ka pasur shkelje ligjore dhe mangësi profesionale nga gjyqtari H. G.; (3) gjykata të konstatojë, se nga 3 prokurorët disiplinor të ZPD-së, të paktën njëri nga ata është dashur t’ia tërheq vërejtjen gjyqtarit H. G.; (4) gjykata vetëm të konstatojë se kryesuesi i këshillit gjyqësor, z. N. H. të tregoj më tepër angazhim dhe jo të sillet dhe jo të jetë indiferent, sikur nuk ka ndodhur asgjë, bazuar në profesionin dhe funksionin e tij që e kishte”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Bazuar në dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se objekti i kërkesës së tanishme nr. KI102/19 është i njëjtë me kërkesën nr. KI174/18 me ç’ rast parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së 3 (tri) shkresave të ZPD-së lidhur me pretendimin për sjellje të paligjshme dhe “joprofesionale” të gjyqtarit H. G.
15. Gjykata konsideron se kërkesa nën shqyrtim nr. KI102/19 e parashtruesit të kërkesës nuk paraqet ndonjë fakt të rëndësishëm për nxjerrjen e ndonjë vendimi të ri, por është thjesht përpjekje e serishme e parashtruesit të kërkesës, për të kërkuar nga Gjykata po të njëjtin vlerësim kushtetues që e kishte kërkuar me kërkesën nr. KI174/18.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116. 1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

17. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që specifikon:

“(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.

18. Duke u mbështetur në rregullin e sipërshtënuar, Gjykata vlerëson se kërkesa e tanishme nr. KI102/19 është thjesht përsëritje e kërkesës së mëparshme nr. KI174/18, të cilën Gjykata e kishte shpallur të papranueshme për shkak se ishte e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën.
19. Gjykata rikujton se ankimi individual sipas kuptimit të nenit 113. 7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtuesit e kërkesës si mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritshme nga Gjykata rihapjen e vendimeve të saj dhe gjykimin e serishëm për të njëjtën çështje (Shih Gjykata Kushtetuese, rastin nr. KI105/16, *parashtues Feti Gashi*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 majit 2017, paragrafi 21).
20. Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një kërkesë që ndërlidhet me të njëjtat fakte sikurse kërkesa e mëparshme, parashtuesi duhet që me të vërtetë të ofrojë informata të reja që më parë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata (Shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Kafkaris kundër Qipros*, ankesë nr. 9644/09, Vendim për papranueshmëri, i 21 qershorit 2011, paragrafi 68).
21. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (Shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI26/14, *parashtues Bajrush Gashi*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 26 marsit 2015, paragrafët 26-27; dhe po ashtu shih, rastin nr. KI105/16, *parashtues Feti Gashi*, cituar më lart, paragrafi 22).
22. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtuesit, në fakt, është kërkesë për përsëritjen e procedurave të mëhershme, tashmë të vendosura nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa nr. KI102/19 refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në mbështetje të nenit 116.1 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Laban Radomir

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi

